

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti diesel per Landfillin Bajkaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134000- 7 Nafte

Në mbështetje të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, neni 55 “Procedure e Hapur e Thjeshtuar, Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu IX “Rolet dhe Përgjegjësitë në Autoritetin/Entin Kontraktor”, Neni 73, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe Urdhërit të Prokurimit **Nr.19 datë 02.07.2025** të Administratori, Njesia e Prokurimit e ngritur me **Urdhër Nr.7 datë 27.06.2025** “Për ngritjen e Njesisë së prokurimit” mbledhur sot në datë **01.07.2025** mori në shqyrtim dokumentet e tenderit me objekt **“Blerje karburanti diesel per Landfillin Bajkaj”**

Për këtë në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, u hap faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ku u morrën dokumentat standarte të tenderit dhe u plotësuan dokumentat e tenderit të mësipërm sipas Dokumentave Standarte të tenderit dhe u përgatiten për hedhjen në sistem.

1. Kërkesat e Përgjithshme për kualifikim të mbeten ato që përcaktohen në Dokumentat Standarte.
2. Kërkesat e veçanta për kualifikim të vendosen si më poshtë:
3. Për përlllogaritjen e fondit limit të buxhetuar, AK është bazuar në cmimin mesatar të kontratave të mëparshme referuar numrit të oreve vjetore të punës së mjeteve në venddepozitim. Sipas vlerës limit të buxhetuar të vitit 2025 prej 7,900,000 leke si dhe cmimit referues në buletin nr 34 datë 07.07.2025 sasia e pritshme e nevojshme për të mbuluar nevojat e Autoritetit Kontraktor, për vitin kalendarik 2025 do të jetë **56,421 litra**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Bajkaj Land” Sh.a ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- 1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**
- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme bazohen në nenet 76, 82 të LPP, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur. (Në rastin e bashkimit të operatoreve secili operator ekonomik duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 43 pika 2/c, pika 3 e pika 4, dhe neni 55 pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar të përcaktuara

në pikën 2.2 i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse ofertuesit zotërojnë kapacitet financiarë për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Vlera e xhiros vjetore të kërkuar është përcaktuar në masën jo më të vogël **se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës**, vlerë e cila është brenda kufijve të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të V.K.M, sipas së cilës vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë, nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar. Kjo vlerë është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj.

ërcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, **2023, 2024**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur operatorët ekonomik ofertues janë në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika c, e ligjit nr.10091, datë.05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. (Në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator ekonomik duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë shërbimi nga një ent publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 40 pika 4 dhe 55 pika 4/b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçencë për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil Diesel 10 ppm) lëshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Licensimit) ose Autorizim apo Licensë për tregtim karburantesh (Gazoil Diesel 10 ppm) për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë”, nenit 40, pika 5, gërma”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial që vërteton që operatori ekonomik nuk ka patur penalitete për shkeljen e cilësisë gjatë vitit 2025. (Në rastin e Bashkimit të operatorëve secili duhet të plotësojë këto kriter.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Ky kriter është i rendesishëm, pasi garanton që Operatori Ekonomik ofron cilesi duke respektuar standardet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar produkt sipas standarteve bashkekohore. Vertetimi i leshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim cilesor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet perkatese për ushtrimin e aktivitetit.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë raport analize për tregun e brendshëm për produktin diesel S.SH.EN:590-2013/A1:2017, leshuar nga Inspektoriati Qendror Teknik, Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit. Raport analiza e tregut të brendshëm duhet të jetë leshuar brenda muajit të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit. Operatori ekonomik duhet detyrimisht të paraqesë një ose më shumë raport analize të tregut të brendshëm. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 6, gërma ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standardet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

2.3.5. Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate Personale ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëjlefshme ose standart ISO me e avancuar (e perkthyer e noterizuar), të cilat do të garantonin cilësinë e produktit dhe shërbimeve. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme, e perditesuar dhe e leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet të jetë e përfshirë objekti i prokurimit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.6. Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë Personale ISO 14001-2015 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të mjedisit dhe /ose të njëjlefshme ose standart ISO me e avancuar (e perkthyer e noterizuar), të cilat do të garantonin cilësinë e produktit dhe shërbimeve. Çertifikata duhet të jetë e

vlefshme, e perditesuar dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë. Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet te jete e perfshire objekti i prokurimit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik duhet te siguroje furnizimin ne objekt sipas nevojave te shoqerise Bajkaj Land Sha. Per arsyen e vendodhjes, dhe ofrimin e furnizimit me karburant duhet te disponojë ne pronesi te vet ose me qera 1 (nje) mjet autobot me kapacitet kapacitet minimumi **1000**, per te cilet duhet te paraqese:

- Çertifikaten e pronësisë së mjetit rrugor te regjistruar ne ekstraktin e QKB.
- Lejen e qarkullimit
- Çertifikatën e kontrollit teknik te mjeteve rrugore. Ne mbeshtetje te ligjit 8378 date 22.07.1998 Kodi Rrugor.
- Police per sigurimin e detyrueshem te mbajtesit te mjetit per pergjegjesi ndaj paleve te treta. Ne mbeshtetje te dekretit nr 6077 date 22.02.2009 dhe ligjit nr 10076 date 12.02.2009.
- Çertifikate e miratimit per mjetet (vetem per brenda vendit) qe transportojne mallra te rrezikshme. Ne mbeshtetje te nenit 37 te ligjit Nr.118/2012 date, 13.12.2012 per transportin e mallrave te rrezikshme.
- Çertifikate e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi. ne mbeshtetje te nenit 41/4, te Ligjit nr.152/2015 për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- Çertifikate konformiteti e cisternes rrugore.
- Dokumentacioni nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise. Ne mbeshtetje te Ligjit nr.9875 date 14.02.2008 për metrologjine.

Ne rastin e marrjes me qera pervec dokumentacionit te mesiperm do te paraqese kontrate noteriale te marrjes me qira të mjeteve. Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar më sipër, për vërtetimin e disponimit të mjeteve në fjalë, ky dokumentacion do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion“, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, mbasi mjetet qe operojne per trajtimin e mbetjeve ne venddepozitim jane mjete te renda qe nuk dalin ne rruge.

Sipas përcaktimit e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë

të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të garantojë me shkrim se merr përsipër furnizimin në Landfillin Bajkaj sipas nevojave të shoqërisë “Bajkaj Land” Sh.a, mbasi mjetet e renda që disponon Autoriteti Kontartor janë stacionare dhe nuk mund të dalin jashtë objektit, për shkak të specifikës së veprimtarisë që kryhet në landfillin Bajkaj (referuar planit të menaxhimit dhe operimit si dhe efekteve negative në mjedis). (Në rastin e bashkimit të operatoreve secili operator ekonomik duhet të garantojë furnizimin me karburant).

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 1 (një) pike karburanti në distance deri në 20 km nga vendndodhja e Landfillit Bajkaj, objekt i Autoritetit Kontrator “Bajkaj Land” Sh.a, e cila do të shërbejë për furnizimin me karburant. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në Ekstraktin e Regjistrimit Tregëtar të Lëshuar nga QKL ose kontrate qeraje) të shoqëruara me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Dokumentacionin e pronësive të stacionit të karburantit
- b) Certifikatën për mbrojtjen nga zjarrin dhe shpëtimin për stacionin e karburantit, Ligji nr.152/2015 për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- c) Vertetim teknik, lëshuar nga ISHTI, për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet e depozitimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Në rast se është me qira ose marrëveshje, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikat a,b,c duhet paraqitur edhe kontrate noteriale qeraje ose akt pronësie sipas Kodit Civil .

2.3.10. Malli do të ofrohet me autobot dhe tollona naftë. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme duke e realizuar këtë kërkesë me shkrim në mënyrë zyrtare. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim. Me paraqitjen e kërkesës nga autoriteti kontraktor kontraktuesi është i detyruar të furnizojë autoritetin kontraktor në kohë dhe sasinë e kërkuar duke përfshirë në çmimin e tyre gjithë detyrimet fiskale që ka shteti shqiptar.

Ligji i zbatueshëm për procedurën e prokurimit është Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në

përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 pika 3/b, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Ky standart është i njëjtë me S SH EN 590:2018 dhe ka statusin e Standartit Shqipëtar.

Nr	Karakteristikat	Njesia	Kufijte e lejuar		Metoda e testimit
			Min	Mak	
1	Numri cetanit		51		S SH EN ISO 5165:2020 ASTM D 613
2	Indeks i cetanit		46.0		S SH EN ISO 4264:2018 ASTM D 976
3	Densiteti ne 15 C	kg/m3	820	845	S SH EN ISO 12185:2001 ASTM D 7777 ASTM D 4052
4	Hidrokarbure aromatic policiklik*	%(m/m)	-	8	S SH EN 12916:2019, ASTM E 1655-05
5	Permbajtja e squfurit	mg/kg	-	10	S SH EN ISO 20848:2019
6	Pika e flakerimit	°C	55	-	S SH EN ISO 2719:2016 ASTM D 93
7	Graviteti API*	llogaritje			ASTM D 4052
8	Permbajtja e hirit	%(m/m)	-	0.010	S SH EN ISO 6245:2002
9	Pika e bllokimit te filtrit ne te ftohte CFFP	°C	-	-	S SH EN ISO 116:2015
10	Korrozioni ne shufer bakri (3 ore ne 50 °C)	Vleresuar	Clas 1		S SH EN ISO 2160:1999
11	Permbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v		7.0	S SH EN 14078 :2014 ASTM D 7806
12	Viskoziteti ne 40 °C*	mm²/s	2.00	4.50	S SH EN ISO 3104:2020 ASTM D 445-15
13	Permbajtja e ujit*	%m/m		0.02	S SH EN ISO 12937:2003
14	Lubriciteti, diametric I korrektuar i gervishtjes (wsd 1.4) ne 60 °C	µm		460	S SH EN ISO 12156-1:2018
15	Pika e turbullimit	°C			S SHEN ISO 3015-2019
16	Mbetje karbon(ne 10% mbetje distilimi)*	%(m/m)	-	0.30	S SH EN ISO 10370:2014
17	Ndotja e pergjithshme	mg/kg		24	S SH EN 12662
18	Stabiliteti i oksidimit (djegjes)*	g/m³	-	25	S SH EN ISO 12205
19	Destilimi Distivlati qe vlon ne 250 °C Distivlati qe vlon ne 350 °C 95% (v/v) Distivlon ne	%(V/V) %(V/V) °C	85	65 360	S SH EN ISO 3405:2019 ASTM D 86
19	Dukshmeria		E qarte e bardhe		ASTM D 4176/2-02

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Mjetet e renda që disponon Autoriteti Kontartor janë stacionare dhe nuk mund të dalin jashtë objektit, për shkak të specifikës së veprimtarisë që kryhet në landfillin Bajkaj (referuar planit të menaxhimit dhe operimit si dhe efekteve negative në mjedis), prandaj dhe furnizimi me karburant do të bëhet në Landfillin

Bajkaj Operatori ekonomik ofertues duhet te kete të paktën 1 (nje) pike karburanti deri **ne 20 km nga vendndodhja e** Landfillit Bajkaj,, objekt i Autoritetit Kontrator "Bajkaj Land" Sh.a , e cila do të shërbeje për furnizimin me karburant.

Emërtimi i mjeteve
MJETI KOMPAKTOR YTO MODEL LLC 233H, Viti i prodhimit 2014, Motorr diesel "CUMMINS", model QSM11/WP 12N Nr. serial 71014905 dhe fuqi 276 kw
Mjeti buldoser/ngarkues me zinxhire, marka LIEBHERR, model LR 624 Litronik, viti i prodhimit Mars 2014, motorr diesel D934 S A6, fuqia e motorrit 105 kW/143 HP, lenda djegese nafte,ambio manuale
MJETI Eskavator me goma "TEREX TLB 840 SM", Viti prodhimit 2014, VIN NUMBER: SMF JB4BC0EGKM3007
Mjeti kamion veteshkarkues, marka SINOTRUCK HOWO 4x2 DUMP, model ZZ3167M3811, VIN namber LZZ5EBMD3ED870535, motorr diesel Nr. 1408070109707, fuqia e motorrit 105 kW/143 HP, lenda djegese nafte,ambio manuale, viti i prodhimit Mars 2014, Euro 4
Gjenerator bajkaj 200 KVA, Model KJR 200ATSB, viti prodhimit 2014, Motorr diesel marka "RIKARDO", Model R6113ZLD1-1, Nr. serial NB. 1407C0016
Gjenerator St Tr Himare, 200 KVA, Model KJR 200ATSB, viti prodhimit 2014, Motorr diesel marka "RIKARDO", Model R6113ZLD1-1, Nr. serial NB. 1407C0016

SASIA E MALLIT QË KËRKOHET DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Afatet e lëvrimit: Nga momenti i nenshkrimit te kontrates deri ne ezaurimin e plote te sasise se prokuruar, ne baze te fondit limit

Për procedurën e prokurimit: “Blerje karburanti diesel per Landfillin Bajkaj" me fond limit **7,900,000 (shtate milione e nenteqind mije) pa T.V.SH.**

Sasia e pritshme e mallit (parashikim i mundshëm) e detajuar ne perputhje me fondin limit, eshte si me poshte vijon:

Artikulli	Përshkrimi	shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	“Blerje karburanti diesel per Landfillin Bajkaj"	56,421	Bajkaj Land sha	Nga lidhja e kontratës deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të kontrates.

Nese brenda afatit 365 dite sasia e karburantit nuk konsumohet kontrata do vazhdoje deri ne perfundim te sasise se kerkuar.

Shënim:

1. Sasitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, janë sasi të pritshme. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të çmimit të publikuar nga APP në buletinin javor.

2. Autoriteti Kontraktor do të përcaktojë sasi të përkatëse gjatë zbatimit të kontratës. **Operatorët do të ofertojnë me normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute. Norma e fitimit të shprehur në vlerë absolute do të jetë e pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave.**
3. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.
4. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shtijes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktor.

Argumentim: Grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi, është hartuar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Në grafikun e lëvrimit të mallit është pasur parasysh natyra, mënyra e ruajtjes dhe magazinimi i mallrave. Në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shënim: Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.